

1

Sfondi dhe Metodologjia

1.1 Sfondi

GJATË VITEVE TË FUNDIT, ne Shqipëri është bërë shumë punë si nga Qeveria ashtu dhe nga Komuniteti Nderkombëtar për të adresuar problemet me kryesore të AVL-ve. Që nga kriza e vitit 1997, gjatë së cilës qindra mijra armë u grabiten nga gazerat e shtetit, janë organizuar një sërë grumbullimesh armësh si nga Qeveria ashtu dhe nga një sërë programesh të PNUD; janë ndërmarrë fushata të ndryshme ndergjegjesimi dhe edukimi; janë forcuar kontrollet e kufirit dhe ende po vazhdon asgjësimi i municioneve.

Duke u mbështetur në kerkimet dhe diskutimet fillestare që u zhvilluan mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Saferworld në periudhën Shtator – Dhjetor 2004, u theksua se mbetet akoma shumë për të bërë dhe se progresi drejt një zbatimi të plotë e të suksesshëm të detyrimeve të Shqipërisë do të pengonte seriozisht pa kuptuar më parë sferën e plotë dhe natyrën e problemit të armëve në Shqipëri duke bërë një vlerësim kombëtar të hollësishëm mbi armet e vogla.

Me financim nga Komisioni Global i Parandalimit të Konfliktëve i Qeverisë Britanike, një fazë kerkimi 6-mujore filloi në Prill 2005 dhe përfundoi në Shtator të të njëjtit vit. Qëllimi i kerkimit ishte:

- Te vlerësohet dhe merret parasysh shtrirja gjeografike dhe demografike e zoterimit dhe përdorimit të armëve të vogla;
- Te vlerësohet dhe të merret parasysh natyra e trafikimit dhe qarkullimit të armëve të vogla;
- Te tregohet ndikimi human dhe social i përdorimit të armëve të vogla;
- Te paraqiteshin masat e krijuara dhe të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e armëve të vogla;
- Te paraqitej shkallëzimi dhe sfera e problemit të armëve të vogla përballë çështjeve të tjera social-ekonomike dhe politike

U shqyrtua gjithashtu që studimi do të formonte fazën e parë të një procesi më të gjërë për t'i dhënë përgjigje të koordinuar çështjeve të AVL-ve. Faza përgatitore e studimit u shoqërua nga diskutime në brendësi të rezultateve të nxjerra nga kerkimi dhe të përgjigjeve të mundshme të politikave. Një dokument i vecantë, që përmban gjetjet dhe rekomandimet fillestare, iu paraqit të gjitha Ministrive përkatëse të Qeverisë dhe disa organizmave ndërkombëtare. Komentet e tyre u kerkuan në një seri takimesh individuale dhe me shkrim. Me në fund, në Tetor 2005 u mbajt një mbledhje nderministrorë në tavolinë të rrumbullakët për të diskutuar gjetjet dhe për tu

mundesuar ministrive te ndryshme te koordinonin pergjigjet e tyre. Komentet e marra jane reflektuar ne dokumentin e rekomandimeve perfundimtare si dhe ne paragrafet perkates te studimit.

1.2 Metodologjia

Pe te grumbullur te dhenat e kerkuara per nje studim te plote, skuadra e Saferworld perdori nje llojshmeri burimesh me qellimin per te siguruar nje nivel te larte te saktetise si dhe te lejonte nje analize me te thelle te faktoreve dhe dinamikave qe kane lidhje me AVL-te. Burimet perfshine:

- Nje studim mbarekombetar **mbi familjen**, drejtuar ne partneritet me Institutin e Studimeve dhe Opinioneve, nje organizate me baze kerkimet e tregut e vendosur ne Tirane. Pyetatori u krijua mbi bazen e Protokolleve te Studimit te SEESAC, i pershtatur per te marre parasysh mjedisin e vecante dhe ceshtjet prezente ne Shqiperi. U perzgjodh nje kampion prej 1200 te pyeturish, duke lejuar per nje marxhine te gabimit prej me pak se 2% dhe per nje nivel besueshmerie prej 95% dhe duke perfaqesuar shperndarjen propocionale te populates.

Per te zhvilluar kampionin, si shtrese baze u zgjodh bashkia dhe me pas u perzgjodhen nje numer fiks pikash kampione, duke perdorur Fushat e Numerimit nga Rregjistrimi i Popullsise ne vitin 2001. Kjo teknike u konsiderua si me shkencorja dhe me rastesorja qe mund te zbatohet me statusin aktual te regjistrave ne Shqiperi. Per te perzgjedhur rastet u perdor teknika e zgjedhjes se rastesishme. Ne vend te perzgjedhjes se familjeve nga nje rregjister emeror, p.sh Rregjistrat e Popullsise, perzgjedhja e rastesishme perfshin intervistues qe fillojne nga pika qendrore e seciles Fushe Numerimi duke perzgjedhur cdo shtepi te trete, ose cdo apartament te peste ne godinat e larta. Kjo teknike lejon perzgjedhjen e rastesishme te njerezve qe jetojne ne zonen e specifikuar ne nje kohe te caktuar. Nese do te aplikohet teknika emeruese do te kishte qene absolutisht e veshtire te gjendeshin emrat e perzgjedhur per shkak te levizjeve te brendshme te populates.

- **Raste studimore** ne shtate qytete (Berat, Fier, Gjirokaster, Korce, Kukës, Shkoder dhe Tirane). Kur u zgjodhen vendet per rastet studimore, u moren ne konsiderate kriteret e meposhtme:
 - Afersia me gazerat
 - Ekzistenca e meparshme e industrise se AVL-ve
 - Çeshtje te trafikimit/kufirit
 - Niveli i interesit nderkombetar
 - Kultura historike ose bashkekohore mbi armet
 - Nivelet e varferise
 - Shkallet e krimit
 - Prezenca e Personave te Zhvendosur Brenda Vendit
 - Popullsia e minoriteteve etnike

Brenda secilit qytet, u intervistuan nga 7 deri ne 14 njerez, perfshi ketu kryetarin e bashkise, drejtorin e keshillit te qarkut, perfaqesues perkates te drejtorive lokale te policise, gjykates ose prokurore, perfaqesues te OJQ-ve, drejtore spitalesh dhe drejtore te shkollave lokale. Temat kryesore te intervistave perfshine ndikimin e AVL-ve, shperndarjen e AVL-ve, programet e grumbullimit te armeve dhe ceshtje qe kane te bejne me trafikimin. Pervet intervistave, u mblodhen statistika te nivelit lokal me qellim qe te krahasoheshin me, ose te plotesonin statistikat ne nivel kombetar.

- **Gjashte fokus grupe.** Ne tre vende te rasteve studimore, Fier, Shkoder dhe Tirane, fokus grupet u organizuan me nje grup burrash dhe nje grup te dyte, me gra. Mosha e pjesemarrësve ne fokus grupet varionte nga 18 ne 57. Temat kryesore perfshine eksperiencia te krimit, ne pergjithesi dhe ne lidhje me AVL-te, perceptimin e zoterimit te AVL-ve, mundesite per grumbullimin e AVL-ve dhe eksperiencia personale te

zoterimit të AVL-ve. Në Shkoder u vu një theks edhe mbi traditën dhe ndikimin e saj mbi zoterimin e AVL-ve.

- **53 intervista kyce informuese** për të patur informacion për, dhe vlerësuar, kapacitetet dhe burimet e shtetit, të dhenat zyrtare, politikën, praktikën, problemet e identifikuar, masat dhe iniciativat e kaluara në lidhje me kontrollin e AVL-ve. Mes informuesve kyce ishin zyrtarë të Qeverisë, policisë, aktorë ndërkombëtarë, përfaqësues të OJQ-ve, ish-oficerë të ushtrisë dhe gazetarë.
- **Një shqyrtim i burimeve perkatese** (si ndërkombëtare ashtu dhe kombëtare) të publikura për AVL-të ose ceshtje të lidhura me to, përfshi për shembull, studime të mëparshme me përmasa të vogla, kërkime mbi reformat ushtarake dhe sigurisë, raporte mbi të drejtat e njeriut, etj.
- **Monitorimi i medias** për artikujt e botuar në gazetën kombëtare. Shekulli në periudhën Janar 2002 dhe Maj 2005. Gjatë kësaj periudhe, artikujt u analizuan për ngjarje të tilla si vrasjet, tentativat e vrasjeve, armembajtjet pa leje, sulmet dhe kërcenimet me armë, me qëllim krijimin e një tabloje me të qarta të frekuencës së këtyre ngjarjeve. Shekulli ishte i vetmi burim i përdorur për këto komponente kërkimi, pasi është e vetmja gazete kombëtare në Shqipëri me arkiv elektronik.
- **Statistikat zyrtare** për të mbështetur informacionin e dhënë në intervista dhe për të siguruar një tablo të ndikimeve të AVL-ve në Shqipëri. Për shkak të kufizimeve aktuale të grumbullimit të të dhënave në Shqipëri, për shembull mungesën e databazave të kompjuterizuara, ky element kërkimi ishte i një vlere të kufizuar, sidomos seksioni i ndikimit.

1.3 Hyrje

Pershtypjet për Shqipërinë zakonisht theksojnë zhvillimin e dobët ekonomik, izolimin ndërkombëtar dhe shtypjen e brendshme të rregjimit komunist të Enver Hoxhës (1946–1985) dhe përpjekjet e vazhdueshme për t'i kapërcyer këto trashëgimi në një nga vendet me të vogla, të varfra dhe me pak të zhvilluara në Europë¹. Në vitin 2003, Shqipëria kishte GDP e dytë me të vogël për frymë nga shtatë vendet ballkanike sipas Komisionit Ndërkombëtar të Ballkanit, me €1709, dhe e dyta për nivelin e ulet të të ardhurave neto sipas Investimeve Direkte të Huaja (IDH) me €158 milion.² Në të njëjtën kohë, ndërmjet viteve 1998 dhe 2001 raportet tregonin shkallen me të lartë të rritjes mes vendeve ballkanike, mesatarisht tërë për qind në vit,³ dhe gjashtë për qind në vitin 2003.⁴ Ndërsa shkalla e rritjes nuk tregon plotësisht nivelin e ulet të zhvillimit, këto statistika makroekonomike fshehin gjithashtu kontrastet e konsiderueshme rajonale që ekzistojnë në Shqipëri. Raportet tregojnë se ka një ndryshim të madh ndërmjet kryeqytetit Tiranës dhe qyteteve të pasura bregdetare siç është qyteti port i Durrësit, dhe pjesës tjetër të thellë të Shqipërisë. Përveç kësaj, ato nuk tregojnë shkallen në të cilën të ardhurat nga aktivitetet e tregut gri dhe të zi kontribuojnë në standartet e jetesës në popullsinë shqiptare.⁵

Shqipëria ishte vendi i parë ish-komunist që aplikoi për të hyrë në NATO, që ka qenë aktiv në programin e saj Partneritet për Paqe (PfP) dhe u lavdërua për progresin e bërë në reformat në ushtri dhe në përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare.⁶ Në vitin 1992 Shqipëria u bë shteti i parë në Ballkanin perëndimor që firmosi një marrëveshje të

¹ Biberaj E, Shqipëria në Tranzicion: Rruga e Veshit drejt Demokracisë, (Westview Press, 1999); Përfaqësuesi i NGO P, Kërkimi për një Shqipëri me të Madhe, (C. Hurst & Co., 2003); Saltmarsh D, Identiteti në një Shtet Ballkanik Post-Komunist: Një Studim mbi një Fshat Shqiptar, (Ashgate, 2001). Këto tërë mendime janë pasqyruar në raportet ndërkombëtare të mediave mbi Shqipërinë.

² Bosnia kishte GDP me të ulet për frymë në rajon me €1611, ndërsa Maqedonia kishte të ardhurat me uletë neto FDI me €83.5 milion. Ballkani në të Ardhmen e Europës (Raporti i Komisionit Ndërkombëtar mbi Ballkanin, Sofje, Prill 2005), f. 39.

³ Pettifer J, Shqipëria, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova: Shtetet në Evolucion dhe Bashkimi Europian, (Qendra Kërkimore për Studimin e Konfliktëve G116, 2002), f. 5.

⁴ Shqipëria në Shifra 2004, (Tirana: INSTAT), f. 35.

⁵ Një analist ka sugjeruar se me shumë se dyzet për qind e GDP reale në Shqipëri ndodhet në sferat gri dhe të zeze të ekonomisë. Shiko: Moustakis F, 'Kërcenimet e Buta të Sigurisë në Europën e Re: Rasti i Rajonit të Ballkanit', Sigurimi Europian Security, 13(1–2), 2004, f. 149.

⁶ Boyne S, 'Komunistet shqiptarë po paguajnë për të shkuarën', *Revista Inteligjente Jane*, 8(10), Tetor 1996, fq. 440–1.

tregtise dhe bashkepunimit me Komunitetin Europian, edhe pse progresi i Marrevshjes së Stabilizim-Asociimit (SAA) ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (BE) ka qenë problematik për një sërë arsyesh. Shqipëria duhet të kapërcejë një sërë sfidash për të plotësuar kërkesat për anëtarësim në BE dhe NATO, po t'i referohemi raporteve të Komisionit Europian për Marrevshjen e Stabilizim-Asociimit që nxjerrin në pah një numër çështjesh që kanë lidhje direkte dhe indirekte me situatën e AVL-ve në Shqipëri:

Raporti i Komisionit Europian për Marrevshjen e Stabilizim-Asociimit rendit prioritetet e mëposhtme për Shqipërinë:

- Shtimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Forcimin e kontrolleve kufitare dhe doganore;
- Forcimin e kapaciteteve gjyqësore dhe administrative;
- Përmirësimin e procesit demokratik dhe stabilitetit politik për të zbatuar reformat;
- Përmirësimin e situatave mbi të drejtat e njeriut dhe minoriteteve;
- Formalizimin dhe reformimin e ekonomisë.⁷

Gjate viteve të fundit, Shqipëria ka hedhur hapa shumë të rëndësishëm për të adresuar problemin e saj mbi AVL-te. Ketu përfshihen grumbullimi i armeve, shkatërrimi i tepërcave, përmirësimi i menaxhimit të rezervave dhe një bashkepunim më i mirë i inteligjencës ndërkombëtare/rajonale dhe për zbatimin e ligjit. Me kalimin e kohës, dinamikat e problemit kanë ndryshuar nga një kërcënim imediat i sigurisë kombëtare në vitin 1997 në situatën aktuale ku armët e paligjshme nxisin krimin dhe trafikun dhe ku problemin e sigurisë të popullsisë manifestohen në një mungesë besimi ndaj shtetit dhe institucioneve të tij, në një pasiguri ekonomike, akses të keq në drejtësi dhe vendim marrje. Prandaj mbetet kritike që problemin e AVL-ve të vazhdojnë të ndalohen në Shqipëri në të gjitha mënyrat e manifestimit.

1.4 Shqipëria në shekullin e njetëzetë

Që prej hartimit të kufijve të Shqipërisë në vitin 1912, ato janë parë si një burim potencial i paqëndrueshmerisë rajonale pasi nuk arriten të kenanin nacionalistët shqiptarë, grekë dhe serbë. Gjate gjithë shekullit të njetëzetë ekzistonte frika se pretendimet greke ose serbe mbi territoret e njohura si të Shqipërisë do të conin në dhunë mes shteteve. Prezenca e pakicave etnike shqiptarë të konsiderueshme në pjesë të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë (FRY), vecanerisht në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, nxiten shqetësime se Tirana mund të kerkonte të krijonte një "Shqipëri me të Madhe" duke i bashkuar këto territore me forcë.⁸ Edhe pse here pas here janë bërë deklaratatë në të shkuarë e afert dhe të lagertë në po të njëjtat linja⁹, sot asnjë parti politike e rrymes në Shqipëri nuk e lidh veten me një pozicion të tillë.¹⁰

Detyra për modernizimin e Shqipërisë dhe krijimi i një identiteti të përgjithshëm kombëtar brenda kufijve ekzistuesë të Shqipërisë është parë nga një numër komentatorësh si një shqetësim shumë më i ngutshëm për udhëheqësit politikë shqiptarë sesa një kërkesë për të përvetësuar territoret fqinje.¹¹ Ndryshimet kulturore, ekonomike gjyqësore, politike dhe sociale që ndajnë banorët e Shqipërisë veriore

⁷ Komisioni i Komunitetit Europian, Komisioni i Letrave të Stafit Punonjës: Shqipëria – Raporti i Stabilizim – Asociimit 2004, (Bruksel, SEC (2004) 374 / 2); Ilirjani A, 'Shqipëria dhe Bashkimi Europian', Politikat Mesdhetare, 9(2), 2004, f. 261.

⁸ Op cit Biberaj; Grupi i Krizave Nderkombëtare, Pan-Shqiptarizimi: Sa i Madh është Kërcënimin për Stabilitetin në Ballkan? (Tirana/Bruksel: Raporti i Europës 153, 25 Shkurt 2004); Judah T, 'Shqipëri me të Madhe?', I Mbijetuar, 43(2), 2001, pp. 7–18; op cit perfaqësuesi i OJF; op cit Pettifer.

⁹ Një nga shkaqet më të fundit lidhur me idenë e një "Shqipërie të Madhe" lindi kur Akademia Shqiptare e Shkencave publikoi një platformë që skicoi kufijtë e "rinj" për një Shqipëri që do të përfshinte zonat me popullsi të konsiderueshme etnike shqiptarë dhe tokat e 'lashta' shqiptarë. Platforma për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1998)

¹⁰ Përveç kesaj mungese të perfaqësimit politik, Komisioni Nderkombëtar për Ballkanin sugjeroi se kërcënimin për një "Shqipëri me të Madhe" ekziston akoma. Kjo bazohet në të dhenat e grumbulluara nga një sondazh opinionesh. Burimi: op cit Ballkani në Europën e Ardhshme, f. 17.

¹¹ Op cit Biberaj; Blumi I, 'Politikat e kultures dhe pushtetit: Rrenjet e shtetit post-lufte të Hoxhës', Tremujorja Europiane Lindore, 31(3), 1997, pp. 379–98; op cit perfaqësimi i OJF; op cit Saltmarsh.

(Geget) me banoret e Shqipërisë jugore (Tosket) janë të dokumentuara me se miri. Lufta për pushtet ndërmjet grupeve nga veriu dhe jugu për të kontrolluar burimet kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë, cuan, në shekullin e njëzetë, në kontraste rajonale në zhvillimin ekonomik, por ndodhen në një kohë kur shumë perpjekje po beheshin për të ndërtuar një tregues kombëtar që do të maskonte ndryshimet rajonale dhe do të njetrajtesonte popullatën.¹²

Historia e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë në Shqipëri u dominua nga Enver Hoxha, udhëheqësi i Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH, deri në vitin 1948 kur u kthye në Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH).¹³ Për një fazë të hershme, influenca jugore në PKSH ishte e fortë, gjë që çoi në themelimin e rregjimit të eger Stalinit përmes të cilit Hoxha sulmoi kulturën e Gegeve, bazat ekonomike, udhëheqjen, gjuhën dhe mënyrën e jetesës,¹⁴ për të krijuar një shtet me dominim Tosk.

Frika e pushtimit ishte shkaku themelor për krijimin e një shoqërie ushtarake dhe të izoluar me pjesën e jashtme.¹⁵ Janë bërë trajnime ushtarake neper shkollë dhe fabrika, deri në tre vjet shtet ushtarak i detyrueshëm dhe njësi të mbrojtjes civile, të gjitha të krijuara për të siguruar që Shqipëria të mund të mbrohej me anë të mobilizimit civil me taktikë Guerilase.¹⁶ Në fund të shekullit të njëzetë Hoxha izoloi jo vetëm nga Europa Perëndimore, por edhe nga anëtarë të tjerë të bllokut socialist. Madje edhe kater vjet pas vdekjes së Hoxhës, kohë kur rregjimet komuniste po binin në të gjithë Europën, pasardhësi i Hoxhës, Ramiz Alia, kërkoj të sigurohej që Shqipëria të vazhdonte të ishte rregjimi i fundit komunist në Europë.¹⁷ PPSH madje arriti të ngjitej në pushtet duke fituar një shumicë vendesh në zgjedhjet shumë-partiake të mbajtura në vitin 1991. Gjithsesi, ajo u përjashtua përfundimisht me fitoren e një lumi votash nga ana e kundërshtarëve të tyre kryesore të Partisë Demokratike (PD) në vitin 1992. Kur PD mori pushtetin, papunësia ishte 300 për qind, GDP për frymë ishte \$222 dhe Shqipëria mori \$116 për frymë nga ndihmat ndërkombëtare, asistencë me e lartë dhënë ndonjëherë për ndonjë shtet ish komunist.¹⁸ Me veriorin Sali Berisha, si udhëheqës të partisë së safj, Qeveria e PD pritej të korrjonte cekuilibrin ekonomik në favor të veriut.¹⁹

1.5 Piramidat dhe Kallashnikovet: pasiguria civile në 1997

Kolapsi i kompanive të skemave piramidale në Shqipëri në fund të vitit 1996 dhe në fillim të vitit 1997 u pa si shkaku kryesor për pasigurinë civile që ekzistoi në Shqipëri në gjysmën e parë të vitit 1997. Kolapsi i këtyre skemave mendohet të ketë prekur kursimet e qindra mijerave shqiptarëve. Një vlerësim deklaroi se mbi një miliard dollarë, rreth një e treta e GNP të Shqipërisë në atë kohë,²⁰ u investua në skemat piramidale ku premtoshin norma të interesit deri në 50 për qind.²¹ Protestuesit bllokuan rrugët në qytetet e jugut të Shqipërisë dhe në Tiranë, dhe ndertesat e Qeverisë dhe PD në Berat, Lushnjë dhe Vlorë u bënë objektiva për grabitje dhe vnie zjarri. Në shkurt, demonstratat u përhapen në të gjithë jugun, ku grabitesist vuna në shenjester depot ushtarake dhe stacionet e policisë. Në 2 Mars 1997, Presidenti Sali Berisha shpalli

¹² Per shembull shiko koleksionin e eseve në eds Scwander-Sievers S dhe Fischer B J, Identitetet Shqiptare: Mitet dhe Historia, (Hurst, 2002). Shiko gjithashtu: op cit Blumi, pp. 379–98.

¹³ Shiko për shembull: Bailey R, 'Tym pa zjarr? Shqipëria, SOE dhe "Teoria e Komplotit" Socialist, në eds Scwander-Sievers dhe Fischer, (2002), pp. 143–53; op cit Blumi, pp. 379–98; Doll B, 'Marredhenia ndërmjet sistemit klanor dhe institucioneve të tjera në Shqipëri veriore', Gazeta e Studimeve të Europës Juglindore dhe Detit të Zi, 3(2), 2003, pp. 147–162; Saltmarshe, (2001); Standish A M J, "Roli i Enver Hoxhës në zhvillimin e miteve socialiste shqiptare", në eds Scwander-Sievers dhe Fischer, (2002), pp. 115–24.

¹⁴ Op cit Biberaj, p. 16; op cit Blumi, pp. 385–6; op cit Doll, pp. 157–8.

¹⁵ Bumçi A, 'Reforma në fushën e sigurisë në Shqipëri', në 'Mbrojtja dhe Reforma në Fushën e Sigurisë në Europën Juglindore': Vështrim i brendshëm dhe perspektivat – Shqipëri: Një studim mbi vetevlerësimin, (DCAF, 2003), pp. 3–26.

¹⁶ Op cit Boyne, pp. 438–41; de Leonis Andres, 'Mbetjet e mbrojtjeve të Shqipërisë', *Revista Inteligjente Jane*, 7(7), Korrik 1997, pp. 295–8; Smith C dhe Sagramoso D, 'Trafikimi i armeve të vogla mund të eksportoje anarkinë e Shqipërisë', *Revista Inteligjente Jane*, 11(1), Janar 1999, pp. 24–8.

¹⁷ Op cit Saltmarshe, p. 60.

¹⁸ Ibid p. 61.

¹⁹ Op cit Biberaj, pp. 205–6.

²⁰ Op cit Hunt.

²¹ Op cit Biberaj, p. 317.

gjendje te jashtezakonshme te shtetit dhe deklaroi: “Rebelet komuniste te armatosur, te ndihmuar dhe te financuar nga sherbimet e huaja te spiunazhit, kane filluar veprimet ushtarake per te permbysur Qeverine me force dhe per te vendosur sundimin e tyre ne te gjithë vendin (...) Ata shume shpejt do te ndejne doren e hekurt dhe ndeshkimin e plote te ligjeve te ketij shteti.”²²

Ne ate kohe u tha se Vlora ishte pika kyce per pasiguri ne Jug si ish-vendi i rekrutimit te policise secrete ne kohen e komunizmit, Sigurimi.²³ Nje numer burimesh te tjera kane sugjeruar se ish personeli i forcave te sigurimit te kohes se komunizmit dhe zyrtare te PS perfituan nga pakenaqesa popullore me pergjigjen e Qeverise ndaj kolapsit te kompanive te skemave piramidale. Pakenaqesite personale ekonomike me teper sesa ndreqja politike mund te kene qene shume mire faktori motivues mbrapa kesaj pasigurie:²⁴ fakti qe rebelet nuk dukej se kerkonin me shume sesa doreheqjen e Berishes i hutoi disa komentatore, te cilet prisnin qe grabitja e armeve te shoqerohej nga nje arsye me e madh e qellimeve politike.²⁵ Te tjere argumentuan se shume njerez ishin thjesht te inatosur dhe moren armet per vetembrojtje si nje forme rimbursimi nga shteti. U pohua gjithashtu se disa nga oficeret dhe ushtaret qe ruanin depot ushtarake u perfshine direkt ne grabitjen armeve dhe depove te municionit.²⁶ Pati gjithashtu spekulime se tensionet mes veriut dhe jugut te vendit do te conin ne nje lufte civile kur depot ushtarake ne Shqiperine e veriut ishin bastisur.²⁷

Ne kohen kur Operacioni Alba, forca shumekombeshe e udhehequr nga Italia dhe e mbeshtetur nga Keshilli i Sigurimit i Kombeve te Bashkuara, arriti ne Prill 1997, komentaret raportuan se mundesia per nje lufte civile u perjashtua.²⁸ Forca beri pak per te prekur situaten, pasi qellimi kryesor ishte shoqerimi i karvaneve te ndihmave, dhe asaj “i mungonte deshira politike te niste nje operacion per carmatimin e gangstereve te armatosur, te rivendoste ligjin dhe rregullin dhe te ndihmonte te krijoheshin kushtet e nevojshme per zgjedhje te lira dhe te drejta”.²⁹ Keto detyra iu lane plotesisht autoriteteve Shqiptare ne vijim te gjendjes se pasigurise. Gjuajtjet dhe vrasjet vazhduan, ku shifrat zyrtare per numrin e njerezve te vrare ndermjet 1 Marsit dhe 20 Shtatorit 1997 ishin 1,311,³⁰ dhe 1,450 te plagosur.³¹

Ne Shtator 1997, Ministri i Mbrojtjes, Perikli Teta, vleresoi shtrirjen e demit ne gjendjen e pasigurise ne pranvere, duke llogaritur si fillim se ishin shkaterruar 1,200 depo ushtarake, me rreth 652,000 arme te kalibreve te ndryshme, rreth 1.5 miliarde municione, 3.5 milione granata dore, 3,600 ton pajisje eksplozivi dhe nje million mina te grabitura nga keto depo.³² Ai nuk deklaroi perqindjen e rezerves totale qe ato perfaqesonin, por nje ish-zyrtar i larte i sigurimit informoi grupin e kerkimit se jo me shume se 50,000 SALW mbeten ne duart e forcave ushtarake shqiptare pas gjendjes se pasigurise ne vitin 1997 me nje perlllogaritje prej 600,000 AVL-ve te grabitura.³³

22 Robertson J, ‘Albania shpall emergjence’, *The Guardian*, 3 Mars 1997, p. 1.

23 Pettifer J, ‘Policia secrete perdor rregullat e vjetra’, *The Times*, 4 Mars 1997.

24 Intervista, Perfaqesues i OJF, 23 Korrik 2005; Op cit Biberaj, p. 319–26; op cit Bumçi, p. 5; op cit Perfaqesues i OJF.

25 Loyd A, ‘Oferta e Berishes per marreveshje sherben vetem per te shtuar terbimin e rebeleve’, *The Times*, 11 Mars 1997.

26 Op cit Perfaqesues i OJF.

27 Disa burime thone se depot u hapen me urdher te Partise Demokratike – shiko per shembull: Bahaja Z, ‘Bashkepunimi civilo-ushtarak dhe mes agjensish ne fushen e sigurise ne Shqiperi’, ne Reformat ne Fushen e Sigurise, A funksionon kjo? Probleme te Bashkepunimit Civilo-Ushtarak dhe Mes Agjensish ne Fushen e Sigurise, Philipp H. Fluri & Velizar Shalamanov (eds), (DCAF / George C. Marshall Association, Bulgaria), 2003; op cit Perfaqesues i OJF P, p. 323. Te tjere thone se ato u grabiten – shiko per shembull: op cit Biberaj, p. 325; Walker T, ‘Besniket e Berishes ngrene spektrin e nje lufte Veri-Jug’, *The Times*, 12 Mars 1997.

28 Sikorski R, ‘Lufte dhe Rregull’, *The Times*, 3 Maj 1997.

29 Op cit Biberaj, p. 326. Borger J, ‘Shqiperia e mundur nga keqardhje’, *The Guardian*, 26 Prill 1997; Owen R, ‘UN aprovon planin per trupa per mbrojtjen e ndihmave ne Shqiperi’, *The Times*, 29 Mars 1997; Walker T, ‘Troops run media gauntlet to take Albanian beaches’, *The Times*, 16 Prill 1997.

30 Nga ky total, 126 u vrane aksidentalisht, 75 ishin femije dhe 52 ishin police ne detyre.

31 23 per qind a atyre te plagosur ne pranveren dhe veren e vitit 1997 ishin femije. Policia deklaroi se per te njejtën periudhe vetem ne Tirane, 197 njerez u vrane nga armet e zjarrit (perfshi kater femije), gjashte nga granatat (perfshi tre femije) dhe 29 vdiqen nga shperthimet (perfshi pese femije). Burimi: ‘Armet e zjarrit vrane 197 ne Tirane ne Mars-Shtator’, Koha Jone, Tirane, ne Shqip, 2 Tetor 1997, f. 2. Burimi: NISAT Database i Arkivit te Tregut te Zi, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

32 ‘Ministri i Mbrojtjes siguron te dhena mbi vrasjet, kthimet e armeve’, Tirana ATA, ne Anglisht, 1646 GMT, 22 Shtator 1997. Burimi: Database i Arkivit te Tregut te Zi, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

33 Intervista, Perfaqesues i OJF, 23 Korrik 2005. Smith dhe Sagramoso (op cit, p. 25) sugjerojne se rreth 80 per qind e rezervave te SALW te Ministrise se Mbrojtjes u grabiten, ndersa zyrtaret e Ministrise se Mbrojtjes informuan skuadren e kerkimeve se 95 per qind e rezervave te SALW te Shqiperise u grabiten ne vitin 1997 (Interviste, Zyrtare te Ministrise se Mbrojtjes, 27 Korrik 2005).

Perlllogaritje te tjera jozyrtare jane me te larta, ku disa argumentojne te jene midis 750,000 dhe 1 milion AVL te grabitura ne vitin 1997.³⁴ Sipas shifrave zyrtare te leshuara pas nje inventari te plote te kryer ne vitin 1998, numri total I AVL-ve te grabitura nga depot e Ministrise se Mbrojtjes ishte 524,226.³⁵ Pervec kesaj, 23,929 AVL u grabiten nga depot e policise dhe 1,620 nga depot e policise sekrete. Keshtu qe, numri total zyrtar i AVL-ve te grabitura nga depot e Qeverise ne vitin 1997 eshte 549,775.

Besueshmeria e kesaj shifre vazhdon te vihet ne pyetje per nje numer arsyesh,³⁶ dhe kjo e ben edhe me te veshtire shkallen e perlllogaritjes se zoterimit aktual te armeve pa leje nga civilet (shiko paragrafin 3.5.2 – ‘Armet e mbajtura ilegalisht’). Problemet me inventarin fizik te vitit 1998 qe u krye ne vijim te grabitjes perfshine edhe faktin qe ne hyrje te depove u vendosen mina per te frenuar civilet te hynin. Por kjo nenkuptoi gjithashtu qe rekrutet shpeshhere ngurronin te futeshin ne nje ndertese, se njerezit ne ngarkim te depove shqetesoheshin se mos hynin ne telash dhe kishin mbajtur arme te vecuara ne disa raste. Por kjo gjithashtu nenkuptonte se rekrutet shpesh ngurronin te hynin ne nje ndertese me friken se mos personat ne detyre mund te futeshin ne telashe dhe mund te kishin arme qe i mbanin menjane. Inventari sigurisht qe nuk ishte 100 per qind i sakte.³⁷

Ne Gusht te vitit 1997, Qeveria Shqiptare shpalli amnesti per ata qe dorezuan vullnetarisht armet e parregjistruara, nje mase qe vazhdoi, edhe pse me nderprerje te shkurtra dhe modifikime, edhe per tete vitet ne vazhdim.³⁸ Ne Shtator te vitit 1997, policia kishte filluar tashme grumbullimin e armeve, duke deklaruar se me shume arme ishin dorezuar vullnetarisht sesa grumbulluar nga nderhyrjet aktive te policise.³⁹ Ne fund te muajit Maj 2005 autoritetet shqiptare, te ndihmuara dhe nga UNDP dhe OJQ, kishin grumbulluar, marre dhe kapur 222,918 AVL.⁴⁰ Zyrtare te grumbullimit te armeve e kane zbritur kete shifer nga perlllogaritja zyrtare prej 549,775 AVL-ve te grabitura dhe sugjeruan se 40.5 per qind e AVL te grabitura tashme jane marre ne konsiderate,⁴¹ per te thene se 326,857 nga armet e grabitura ekzistojne ose ne Shqiperi ose jashte shetit.

1.6 Trafikimi dhe konflikti rajonal

Megjithese ekspertet ne pergjithesi nuk argumentojne se nje politike per nje ‘Shqiperi me te Madhe’ eshte drejtuar nga Tirana, grupe etnike shqiptare kryengritese ne Kosove dhe Maqedoni kane perfituar transferta direkte dhe indirekte te armeve shqiptare AVL te grabitura qe kane udhetuar tranzit permes Shqiperise qe nga viti 1997. Megjithate, eshte argumentuar se trafikimi i AVL-ve nga ose nepermjet Shqiperise per ne Kosove ka ndodhur edhe me pare se te ndodhte grabitja e armeve shqiptare ne vitin 1997, edhe pse ne nje shkallezim me te kufizuar sesa gjate periudhes 1997–2000. Paulin Kola ve ne dukje deklaratat e bera nga Xhavit Haliti, ish-udheheqesi I Levizjes Popullore per Republikën e Kosoves, i cili e informoi ate se Presidenti Socialist shqiptar Ramiz Alia autorizoi ndihmesen e ushtrise shqiptare dhe madje asistoi me dergesat e para te AVL-

34 Shiko per shembull: op cit Bahaja; op cit Smith dhe Sagramoso, f. 25. Nje vleresues sugjeron se rreth 80 perqind e rezervave SALW te Ministrise se Mbrojtjes u grabit.

35 Burimi: Shifrat e Komitetit te Grumbullimit te Armeve.

36 Interviste, zyrtar nderkombetar, 12 Prill 2005.

37 Interviste, ish-zyrtar in Ministrise se Mbrojtjes, 18 Prill 2005.

38 Pati nje nderperje te shkurter ndermjet 4 Gusht 2002 dhe 6 Mars 2003, kur ne vend nuk kishte nje legjislacion per amnesti ndaj armeve.

39 Per shembull, nje gazete raportoi se ne Gusht dhe Shtator 1997 forcat policore te Shqiperise kishin grumbulluar 205 pushke automatike, 487 pushke, 72 automatike te lehte, 72 pistoletat dhe 476 granata gjate kerkimeve te tyre. Ne krahasim me, 2,101 pushke automatike, 102 automatike te rende, 230 kilogram eksploziv, gjashte flakehedhese, tete granatehedhese dhe 533,000 cope armatim ishin dorrezuar vullnetarisht ne te njejten periudhe. Burimi: Op cit ‘Armet e zjarrit vrasin 197 ne Tirane Mars-Shtator’. Nje shifer tjeter e grumbullimit te armeve per periudhen 1 Gusht deri ne 20 Shtator 1997 u paraqit nga Ministria e Mbrojtjes. Ai deklaroi cfare ishte grumbulluar: 2,162 pushke automatike, 20,689 pushke, 1,266 automatike te lehte, 78 pistoletat, 518 automatike te rende, 116 arme dhe mortaja, 282 granata anti-tank, 219 arme aeroplanguajtes, 732 mina anti-tank dhe anti-kembesorie, 7,786 granata mesymjeje, 6,060 granata difensive, eight million mjete sulmi kembesorie dhe 1,070 mortaja. Burimi: Op cit ‘Ministri I Mbrojtjes siguron te dhena mbi vrasjet, kthimin e armeve’.

40 Burimi: Sektori i Grumbullimit te Armeve ne Ministrine e Rendit Publik.

41 Megjithese fokusi kryesor i vemendjes nderkombetare ka qene i drejtuar ne mbledhjen e SALW, ia vlen te përmendet se nje sasi e konsiderueshme municioni, eksploziv dhe materialesh te tjera ushtarake, perfshi tanke jane grumbulluar qe prej vitit 1997.

ve ne vitet 1987–8,⁴² dhe se Fatos Nano i dha atij ‘karta-bianken’ “ne menyre qe dergesat e nerezve dhe armatimet te mund te beheshin pa vonesa nepermjet territorit te Shqiperise”.⁴³

Gjithsesi, eshte e qarte se ndermjet viteve 1997 dhe 1999, kur Qeveria Shqiptare dhe autoritetet e shtetit nuk ishin ne gjendje te kontrollohin bandat e medha te territorit te Shqiperise dhe te kufijve shqiptare, ndodhi pershkallezimi i madh i trafikimit te armeve nga dhe permes Shqiperise. Kerkues te ndryshem ishin te nje mendje se anarkia e 1997 dhe rrjedhimet e saj “i siguruan themeluesve te Ushtrise Clirimtare te Kosoves (UCK) pajisjen me arme te vogla dhe nje shtrirje te territoreve te paqeverisura ku ata mund te armatosnin dhe trajnonin nje force guerrilase”.⁴⁴ Ndersa Kola deklaronte se UCK kishte njezve ne Tirane qe grumbullonin arme per t’i derguar ne Kosove,⁴⁵ Shqiperia Veriore shihej ne pergjithesi te ishte vendi kryesor per lulezim e bizneseve te trafikimit te armeve.⁴⁶ Qytetet kufitare te Bajram Currit dhe Tropojes sherbyen si ‘pazare te armeve te paligjshme’ per tregaret lokale dhe simpatizantet e UCK qe mezi prisnin te shisnin ose dhuronin AVL.⁴⁷ Me perfudimin e konfliktit te Kosoves, grupet shqiptare etnike me baze ne Maqedoni, si Ushtria Kombetare Clirimtare (UKC) dhe Ushtria Kombetare Shqiptare (UKSH), u bene marresit e disa prej armeve te hyra kontrabande nga Shqiperia per te furnizuar kryengritjet kosovare ne vitet pasuese.⁴⁸

Edhe sikur autoritetet shqiptare te kishin kapacitetin te bllokonin trafikimin e armeve per ne Kosove ne vitet 1997 dhe 1999, jopopullariteti i ketij veprimi mund ta kishte bere pozicionin e tyre te pambrojtur.⁴⁹ Shqiperia Veriore shihej si pertej kontrollit nga ana e autoriteteve qendrore dhe vazhdoi te ishte nje “shteg per armet dhe njeziti”,⁵⁰ pasi armet e prodhuara ne shtetet e Europes Qendrore dhe Lindore, si dhe ne shtetet anetare te NATOs, trafikoheshin permes kesaj zone.⁵¹ Ne vitin 1999 nje studiues argumentoi se “UCK ka mundesi te gezoje me shume pushtet dhe influence ne Shqiperine e Veriut sesa Qeveria qendrore”.⁵² Padyshim qe mbetet e vertete qe marredheniet komplekse politike, familjare, ekonomike, ushtarake dhe kriminale lidhin shume individe ne Shqiperine Veriore me shqiptare etnike ne Kosove dhe Maqedoni.⁵³

Armet ngopen provincat e Kosoves dhe sipas raporteve nuk kishte me kerkesa per arme nga depot e grabitura ne Shqiperi ose ne tregun e zi ne sasite qe u kerkuan njehere. Ka patur diskutime per importe te vazhdueshme te armeve dhe eksploziveve me teknologji te larte ne Kosove permes Shqiperise, nga trafikues droge qe veprojne ne rajon dhe qe mbajne arme per perdorim personal dhe disa raste individesh qe blejne arme jashte kufijve per siguri vetjake. Ka patur gjithashtu deklarime per trafik armesh

42 Op cit Perfaqesues i OJF, f. 319.

43 Ibid, p. 333.

44 Op cit Grupi i Krizave Nderkombetare, 2004, f. 6; op cit Heinemann-Grüder dhe Paes, pp. 19–21; Judah T, Lufta me celular, gomar dhe kallashnikov’, *The Guardian Weekend*, 29 Gusht 1998, p. 6; op cit Perfaqesues i OJF, f. 343; 393; op cit Smith dhe Sagramoso, f. 25.

45 Op cit Perfaqesues i OJF, p. 330.

46 Op cit Grupi i Krizave Nderkombetare 2004, f. 6; op cit Smith dhe Sagramoso, f. 25.

47 Op cit Smith dhe Sagramoso, p. 26.

48 ‘Furnizuesit me arme te UKC: Trafikuesit e armeve sajojne nje rrjet te nderlikuar per te kundershuar kapjet ne rritje te KFOR ne kufirin maqedonas’, IWRBRCR 272, 17 Gusht 2001; ‘Kosove: KFOR mban ne arrest 27 persona qe perpiqeshin te fusnin arme kontrabande ne Maqedoni ne javen e fundit’, FBIS-EEU-2001-0813, Paris AFP (Sherbimet e Europes Veriore), ne Anglisht, 1422 GMT, 13 Gusht 2001 [FBIS Transcribed Text]. Burimi: Database i Arkivit te Tregut te Zi, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005; Loyd A, ‘Shtetet e Bashkuara luftojne te kapin armet nga rebelet shqiptare’, *The Times*, 6 Mars 2001; op cit Quin, 2003; op cit Ripley, 2001, p. 22.

49 Cf op cit Grupi Nderkombetar i Krizave, 2004, f. 13: “Do te kishte qene nje vetevrasje politike per qeverine [shqiptare] te pikasej sikur po percante aktivitetet guerrilase te UCK ne Shqiperi”. Raporti thekson gjithashtu se gjate krizes Maqedonase ne vitin 2003, qeveria shqiptare u duk te ngurronte te arrestonte aktiviste te njohur te UKC ne Shqiperi.

50 Op cit Perfaqesues i OJF, f. 345.

51 Op cit Heinemann-Grüder dhe Paes, f. 13; op cit Smith dhe Sagramoso, f. 26. Jo te gjitha keto dergesa “tranzite” perfunduan ne Kosove. Ndoshta rasti me i ulet eshte zbulimi ne Maj te vitit 1999 i 30 ton armeve dhe municioneve te ngarkuara ne kamione qe mbanin logon e Agjensise Katolike Romake te Ndhimave Caritas ne portin Italian te Ankones gati per te mberitur ne portin Shqiptar te Durresit. Per me shume informacion mbi kete ceshtje shiko: ‘Kontrollet e ngarkesave me destinacion Shqiperine ndaluan ne Bari’, *Corriere della Sera* (versioni ne internet) ne Italisht, <<http://www.rcs.it/corriere>>, 3 Maj 1999; ‘Italia ndalon konvojine me ndihma me arme per UCK’, *Corriere della Sera* (versioni ne internet) ne Italisht, <<http://www.rcs.it/corriere>>, 3 Maj 1999. Burimi: NISAT Database i Arkivit te Tregut te Zi, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005. Shiko gjithashtu: Owen R, ‘Kontrabandistet e armeve perdoren bamiresine si maskim’, *The Times*, 4 Maj 1999.

52 Op cit Smith, 1999, p. 2.

53 Cf op cit Judah, 2001, p. 18.

nga Shqipëria në Greqi dhe Itali, por volumi mendohet të mos jetë i konsiderueshem si në rastet e llojeve të tjera të trafikimit, dhe pavaresisht nga rreziku fillestar, tregu i BE për armet pa leje nuk raportohej të mbushej me AVL shqiptare të grabitura.⁵⁴ Është argumentuar se armatimet shqiptare të grabitura veshitare se joshnin organizatat terroriste ose kriminale në BE për shkak të cilesisë së tyre të dobët dhe përdorimit të kufizuar.⁵⁵

Një numër raportesh në vitet e fundit kanë tërhequr vëmendjen në faktin se grupet e kimit të organizuar në Shqipëri konsiderohen të jenë në rritje dhe një nga kercenimet kryesore për sigurinë në Europë.⁵⁶ Për shumicën e viteve 1990, shqetësimi kryesor në lidhje me kriminelet e organizuar dhe trafikuesit shqiptarë dukej se ishte trafikimi i qenieve njerëzore ose nga brenda Shqipërisë ose duke e përdorur Shqipërinë si pikë kalimi për në Gjermani, Itali ose me tej. Sidoqoftë, frika kryesore tani duket të jetë trafiku i drogës dhe roli i Shqipërisë si një pikë kalimi për dergesat e heroines nga Afganistani nëpërmjet Turqisë dhe Shqipërisë tek konsumuesit në BE. Prodhimi i brendshëm i marijuanës në Shqipëri ka tërhequr gjithashtu vëmendjen e fqinjve të saj të BE, me Interforza, agjencinë Italiane të zbatimit të ligjit, që asiston në luftimin e rritjes dhe trafikimit të ketij malli.⁵⁷ Neqoftëse me të vertetë trafikimi i armëve është aktualisht minimal, ekziston akoma një nevojë për një kontroll që do të merrej efektivisht me mundësitë që ai të rishfaqej, sic theksohet edhe nga studimet e UNDP dhe SEESAC mbi AVL-të në Bullgari, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi.⁵⁸

Fakti që Shqipëria duket të jetë një rrugë kalimi për armet e përdorura me pare në konfliktet e ish-Jugosllavise është ndoshta dicka që duhet të përbejë një shqetësim në rritje për autoritetet shqiptare dhe BE. Disa nga problemet që marrin në konsideratë AVL-të e grabitura nga depot shqiptarë në vitin 1997 dhe gjithashtu AVL-të nga konfliktet e Jugosllavise mund të kapërceheshin përmes një koordinimi me të mirë të shkëmbimeve të informacionit mbi armet e rimarra dhe të grumbulluara në rajon, me operacionet e koordinuara me SECI 'Ploughshare' dhe 'Vend i Sigurt' të trajtuara si hapa të para drejt krijimit të shkëmbimeve të shpeshta të informacionit për llojet dhe gjurmët e armëve të pasiguruara.

1.7 Krimi i Organizuar dhe korrupsioni

Mund të jepen një numër arsytimesh për të ndihmuar në shpjegimin pse Shqipëria, si edhe fqinjet e saj në Europën Juglindore, ka arritur të shihet me shqetësim, persë i përket krimit të organizuar transkombetar.⁵⁹ Në pari, pozicioni gjeografik i Shqipërisë e bën atë pjesë të "një ure të rëndësishme për rrjetet kriminale që shtrihen që nga Europa Perëndimore deri në Azi e Afrikë".⁶⁰ E lidhur ngushtë me tablonë e terrenit të

⁵⁴ Op cit Smith dhe Sagramoso, p. 27.

⁵⁵ Interviste, Zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 20 Prill 2005; zyrtar nderkombetar, 27 Prill 2005; parlamentar, 3 Maj 2005.

⁵⁶ Barnett N, 'Kercenimi kriminal për stabilitetin në Ballkan', *Revista Inteligjente Jane*, 14(4), Prill 2002, pp. 30–2; Bumçi A, Ymeri S dhe Dakli E, 'Debatë për Sigurinë Kombëtare: Rasti i Shqipërisë – Sigurimi i Kufijve, Besimi dhe Siguria, korrupsioni, (Instituti Shqiptar për Cështjet Nderkombëtare, 2004), f. 40–1; Galeotti M, 'Gangsteret Shqiptarë fitojnë terren në botën e krimit Europian', *Revista Inteligjente Jane*, 13(11), Nëntor 2001, pp. 25–7; Kominek J, 'Krimi i Organizuar Shqiptar gjen shtëpi në Republikën Çeke', *Revista Inteligjente Jane*, 14(10), Tetor 2002, pp. 34–5; op cit Smith dhe Sagramoso, pp. 24–8.

⁵⁷ Interviste, zyrtar nderkombetar, 19 Prill 2005.

⁵⁸ Op cit Rynn, Gounev dhe Jackson; op cit Khakee A dhe Florquin N; op cit Grillot, Stoneman, Risser dhe Paes; op cit Florquin dhe O'Neill Stoneman; op cit Taylor, Phillips dhe BogosAVALjevic.

⁵⁹ Shiko për shembull: artikujt e ndryshëm brenda Athanassopoulou E, 'Te luftosh krimin e organizuar në Europën juglindore', cështje speciale e Gazetes së Studimeve të Europës Juglindore dhe Detit të Zi, 4(2), 2004; Barnett N, 'Mungesa e fondeve, mbikqyrja e pajisjeve dhe korrupsioni zyrtar veshitësojnë detyrën e kontrollit të tregut të paligjshëm të njerezve dhe drogës', IWPRBCR 479, 04 Shkurt 2004, <<http://www.iwpr.net/>>, 7 Prill 2005; Barnett N, 'Kercenimi kriminal ndaj Stabilitetit në Ballkan', *Revista Inteligjente Jane*, 14(4), Prill 2002, pp. 30–2; Bumçi A, Ymeri S dhe Dakli E, 'Debatë mbi Sigurinë Kombëtare: Rasti i Shqipërisë – Sigurimi i Kufijve, Besimi dhe Siguria, korrupsioni, (Instituti Shqiptar për Cështjet Nderkombëtare, 2004); Davis I, Hirst C dhe Mariani B, 'Krimi i Organizuar, Korrupsioni dhe Trafikimi i Armeve paligjshme në një BE të zgjeruar: Sfidat dhe Perspektiva, (Saferworld, 2001); Grillot S, Stoneman S, Risser H dhe Praes W-C, 'Një Paqe e Brishtë: Armet dhe Siguria në një Maqedoni Post-Konflikt, (SEESAC, 2004); Khakee A dhe Florquin N, 'Kosova dhe Arma: Një vlerësim baze i Armeve të vogla dhe të lehta në Kosovë (Studim për Armet e Vogla dhe UNDP Kosovë, 2003); op cit Moustakis; op cit Pettifer, Rynn S, Gounev P dhe Jackson T, 'Taming the Arsenal – Armet e Vogla dhe të Lehta në Bullgari, (SEESAC, 2005); Sagromoso D, Shtimi i Armeve të Vogla dhe të lehta të paligjshme në Bashkimin Europian dhe rreth tij: Paqendrueshmeria, Krimi i Organizuar dhe Grupet Terroriste, (Saferworld dhe Qendra për Studimet e Mbrojtjes, 2001); Taylor Z, Phillips C dhe BogozAVALjevic S, 'Te jetosh me trashëgiminë kulturore – Studimi i SALW në Republikën e Serbisë, (Saferworld, 2005).

⁶⁰ Op cit Athanassopoulou, f. 217. Shiko gjithashtu: op cit Bumçi, Ymeri dhe Dakli f. 18; Totozanni I, 'Civilët dhe ushtria në planin e mbrojtjes: nga një koncept i sigurisë kombëtare në një plan zhvillimi force', në Mbrojtja dhe Reforma në Fushën e Sigurisë në Europën Juglindore: Veshtrim i brendshëm dhe Perspektiva- Shqipëria: Një studim vete-vlerësues, (DCAF, 2003), f. 61.

saj kufitar si ‘teper i eger’ ose i veshtire per policine per nje kontroll efektiv, pozicioni i saj gjeografik jep terheqjen e saj ‘natyrale’ per te interesuarit ne levizjet e mallrave kontrabande dhe njerezve per ne BE.⁶¹

Se dyti, Shqiperia doli nga komunizmi si nje “shtet i dobet ne te cilin institucionet zyrtare kane funksionuar dobet”.⁶² Per shembull, kur PD erdhi ne pushtet ne vitin 1992, ajo shkarkoi dhjetera mijera zyrtare te shtetit per korrupsion dhe lidhje te dyshuara politike me PPSH,⁶³ por nuk i zevendesoi keta njerez detyrimisht me personel me eksperience, kompetente apo te ndershem. Zyrtaret ne kufi, dogana dhe agjensi te zbatimit te ligjit kishin gjithashtu rroga te uleta dhe kushte te keqia pune, duke i bere ata te prekshem ndaj praktikave korruptuese sic ishin pranimi i rryshfeteve ose pranimi ne heshtje i kerkesave te atyre qe kercononin me dhune ose forma te tjera kanosjeje.⁶⁴ Duke qene se perfitime te konsiderueshme duheshin arritur duke thyer sanksionet e imponuara Ish-Republikes Jugosllave (pervec trafikimit te armeve, droges, njerezve dhe mallrave te tjera kontrabande brenda rajonit dhe ne BE), presioni mbi kontrollet e nje shteti akoma te dobet u rrit.⁶⁵

Eshte argumentuar se “boset e krimit te organizuar ne Europe e shohin Ballkanin si nje vend te mire per te bere biznes”.⁶⁶ Lidhjet ndermjet agjenteve te shtetit ne nivelet me te larta dhe grupeve te krimit te organizuar kane bere qe krimi i organizuar te rrenjose ne jeten ekonomike, politike dhe sociale te rajonit; kjo mbeshetet nga frika, cinizmi dhe toleranca e nje pjese te konsiderueshme te popullates, qe vazhdon te kete mungese besimi tek autoritetet shtetore te cilet duhet te sigurojne sigurine baze njerezore.⁶⁷

Nje nga rezultatet e qeverise korruptuese dhe shkaterrimit social ka qene shtimi i gangstereve, disa prej te cileve kane krijuar lidhje me partite politike. Duke qene se aktiviteti kriminal eshte bere me i organizuar, trafikimi i njerezve, droges, armeve dhe formave te tjera te kontrabandes eshte bere gjithmone e me harmonizuar me rrjetet kriminale nderkombetare.⁶⁸

Prandaj, mendohet se nuk ishte vetem fale heshtjes se rojeve kufitare dhe doganore qe u arriten perfitime te konsiderueshme nga thyerja e sanksioneve te FRY dhe trafikimit te mallrave kontrabande nga, permes dhe per ne Shqiperi. Vargu kriminalo-politik duket se ka qene ne gjendje t’i pershtatet ndryshimeve ne Qeveri, me deklarata te bera kunder zyrtareve nga PD dhe PS ne lidhje me lidhjet e tyre te dyshuara me aktivitetet e krimit te organizuar dhe trafikive.

Perpara kalimit te fundit te pushtetit tek Partia Demokratike, autoritetet shqiptare pranuan se krimi i organizuar dhe korrupsioni ishin problemet me te medha e duheshin adresuar. Megjithate, sipas nje raporti te ICG ne vitin 2003, “ata nuk shihet {u pa} te pranonin shtrirjen e plote te lidhjeve [te krimit te organizuar] me individe ne zyrtar e majes se shtetit, policise dhe politikane”.⁶⁹ Raporti vazhdoi te argumentonte se sfida kryesore per Shqiperine ishte te zhdukte krimin e organizuar dhe sponsoret e tij te fuqishem ne Tirane. Ndersa ish-Kryeministri Fatos Nano ishte i sakte kur argumentonte se krimi i organizuar eshte nje problem transkombetar dhe nuk mund te luftohet me sukses nga Shqiperia e vetme,⁷⁰ perpjekjet e Shqiperise ne kete fushe u pershkruan si te ‘varfra’ ne Raportin e 2004-es se KE per Marreveshjen e Stabilizim-

61 Op cit Pettifer, p. 5.

62 Op cit Lawson dhe Saltmarshe, f. 133.

63 Per shembull, Elez Biberaj deklaroi se 70% e zyrtareve te Sigurimit u pushuan ne muajt e pare pasi Partia Demokratike erdhi ne pushtet, me rreth 80% te oficerave ushtarake, anetare te PPSH, te vene ne shenjester. Shiko: op cit Biberaj, f. 152.

64 Bebler A, ‘Korrupsion mes Personelit te Sigurimit ne Europen Qendrore dhe Lindore’, Gazeta e Studimeve Komuniste dhe Politikave ne Tranzicion, 17(1), 2001, pp. 129–45; op cit Moustakis, f. 150; Ruggerio V, ‘Kriminelet dhe ata qe sigurojne sherbim: ekonimite e pista mes kombesh’, Krimi, Ligji & Ndryshimi Social, 28, 1997, pp. 27–38.

65 Cukier W, ‘Armet e Zjarrit: Lidhjet e Ligjshme/te Paligjshme’, Web-site i Edukimit mbi Armet e Vogla te Zjarrit dhe Rrjetit Kerkues, <<http://www.research.ryerson.ca/SAFER-Net/Permbajtja/Permbajtjet/LicitIllicit/Licit-Illicit%20Links.pdf>>, 16 Prill 2003; op cit Davis, Hirst dhe Mariani; op cit Saltmarshe, f. 62 dhe 149.

66 Ripley T, ‘Sundimet e paqendrueshme ne Ballkanin jugor’, *Revista Inteligjente Jane*, 14(3), 2002, f. 39.

67 Op cit Athanassopoulou. Shiko gjithashtu: op cit Lawson dhe Saltmarshe, pp. 133–148.

68 Op cit Saltmarshe, p. 62.

69 Op cit Grupi i Krizave Nderkombetare, 2003, p. 7.

70 Op cit Nano, pp. 8–9.

Asociimit.⁷¹ Raporti theksoi nje legjislacion te keq-percaktuar, kapacitete deficente te inteligjences dhe analizave, koordinim te kufizuar mes qendres dhe rajoneve dhe ndermjet agjensive te ndryshme, korrupsion dhe kerccenim te hetuesve, prokurore dhe gjyqesore te korruptuar dhe te trajnuar dobet, teresia e te cilave çoi ne rezultate te uleta.

Ne perpjekje per te luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, Zv. Kryeminsitri Meta hartoi nje plan anti-korrupsion ne Shtator te vitit 1999.⁷² Sidoqofte, ne fillim te vitit 2003 fushata anti-korrupsion u vleresua si e ‘paefektshme’,⁷³ megjithese nje vit me pare ishte krijuar nje plan vjetor veprimi per parandalimin dhe luften kunder korrupsionit.⁷⁴ Nje nga problemet kryesore mund te ishte se vendosja e ligjit ka themele te dobeta ne Shqiperi, per te cilen nje analist thote se shteti i se drejtes ishte i huaj per Shqiperine Komuniste” pasi edhe Ministria e Drejtesise ishte shfuqizuar gjate rregjimit te Hoxhes.⁷⁵ Fotios Moustakis ka argumentuar se ka patur permiresime te konsiderueshme qe nga viti 2001, por ka akoma nje boshlllek ndermjet letres dhe zbatimit te ligjit.⁷⁶

Raporti i KE 2004 per Marreveshjen e Stabilizim Asociimit argumentoi se ka patur mjaft korrupsion, nderhyrje politike, mungese burimesh njerezore dhe financiare, ndryshime ne stafin e larte dhe mungese profesionalizmi ne te gjithe shtetin shqiptar, me nje gjyqesor dhe agjensi te zbatimit te ligjit te nenvizuara si burime te vecanta shqetesimi per “permiresimet e tyre shume te kufizuara”. Raporti citonte se:

*Shteti i se drejtes ne Shqiperi mbetet deficient. Organizmat shqiptare te zbatimit te ligjit nuk garantojne akoma zbatim te qendrueshem te ligjit, sipas standarteve nderkombetare. Korrupsioni i perhapur gjeresisht dhe krimi i organizuar vazhdojne te jene kerccenime serioze per stabilitetin dhe progresin e vendit.*⁷⁷

Shqetesime te ngjashme ishin renditur ne *Raportin e Sektorit Ligjor per Shqiperine e OSBE ne 2004*, ne te cilin mungesa e besueshmerise publike dhe transparences ishin theksuar si dy shqetesimet kryesore qe has sektori ligjor ne Shqiperi.⁷⁸ Raporti theksoi faktin se zyrtaret shpesh nuk kane mundur te zbatojne vendimet e gjykatave, se nderhyrjet politike i kishin penguar prokuroret te zbatonin detyrat e tyre dhe se fallsifikimi i zoterimit te pronave ishte nje problem madhor per sigurine publike. Gjithsesi, raporti deklaroi gjithashtu se “sektori ligjor ne Shqiperi ka mundesi te kete nje fame me te keqe se c’e meriton”. Mungesa e kuptimit te proceseve gjyqesore nga publiku dhe mungesa e transparences u menduan te ishin dy arsyt kryesore mbrapa kesaj fame, por ishte gjithashtu e qarte se sanksionet nuk ishin aplikuar ne nje menyre strikte dhe uniforme kundrejt individeve me profesionin ligjor te cilet i ishin dorezuar rryshfeteve dhe ishin perfshire ne praktika korruptive.

1.8 Reforma ne Polici

Sic citon dhe Programi Nderkombetar i Asistences Trajnuese dhe Hetimit Kriminal, “Ne vitin 1997, pas nje renie te pergjithshme te rendit publik, Policia Kombetare Shqiptare filloi procesin e ngadalte te krijimit te nje force moderne policore qe u modelua sipas institucioneve te zbatimit te ligjeve ne shoqerite demokratike.”⁷⁹ Qe atehere ceshtja eshte rritur ne rendesi pasi lufta kunder krimit te organizuar,

71 Komisioni i Komunitetit European, Komisioni i Letrave te Personelit: Shqiperia – Raporti i Stabilizimit dhe Asociimit 2004, (Bruksel xxx, SEC(2004) 374 / 2), f. 34.

72 Op cit Smith, 2000, p. 1.

73 Op cit Grupi i Krizave Nderkombetare, 2003, f. 7.

74 Keshilli i Ministrave, Republika e Shqiperise, Plan veprimi per parandalimin dhe luften kunder korrupsionit 2003–2004, Tirane, Korrik 2003.

75 Op cit Biberaj, f. 71.

76 Op cit Moustakis, f. 154.

77 Komisioni i Komunitetit European, Komisioni i Letrave te Personelit: Shqiperi – Raporti per Stabilizimin dhe Asociimin 2004, (Bruksel, xxx, SEC(2004) 374 / 2), f. 2.

78 Prezenca e OSBE ne Shqiperi, Raporti i Sektorit Ligjor per Shqiperine (2004).

79 ICITAP website, <http://www.usdoj.gov/criminal/icitap/albania.html>

trafikimit, korrupsionit dhe permiresimi i rendit publik u bene prioritete strategjike ne perputhje me Marreveshjen e Stabilizim Asociimit me BE. Sic shpjegohet edhe me poshte ne kapitullin 5 ‘Kapaciteti i Kontrollit te AVL-ve’, Qeveria Shqiptare ka prezantuar strategji dhe njesi te reja te caktura vecanerisht per te permiresuar efektshmerine ne keto fusha. Nje mbeshetje e konsiderueshme nderkombetare, si dypaleshe ashtu dhe shumepaleshe, eshte ofruar keto vitet e fundit per te asistuar keto reforma, perfshi ketu:

- Programin e UNDP per Mbeshtetje te Reformave ne Fushen e Sigurise, nje projekt pasues i projektit mbeshtetes per grumbullimin e armeve, Projekti i Kontrollit Te Armeve Te Vogla Dhe Te Lehta, qe ka drejtuar projekte te Policimit ne Komunitet ne Prefekturat e Kukesit, Shkodres, Lezhes, Tiranes dhe Vlores qe nga viti 2003 e ne vazhdim per te forcuar kapacitetet e policise, te nxise nje imazh pozitiv te policise dhe te ndihmoje policine te ndertoje besim tek komunitetet.⁸⁰
- Prezencen e OSBE ne Shqiperi qe siguron asistence ne rendin publik dhe ne ceshtjet e sigurise permes Asistences se saj Policore dhe Njesise se Menaxhimit te Kufijve, perfshi bashkepunimin nder-kufitar, dhe keshillimin e Qeverise Shqiptare per legjislacionin dhe planet strategjike.⁸¹
- ICITAP, qe ka punuar qe nga viti 1998 per t’i dhene trajnime Policise Kombetare Shqiptare dhe keshilla mbi planet strategjike dhe teknikat anti-kontrabande, aktualisht duke ndihmuar per te krijuar nje njesi te dedikuar kunder krimin te organizuar.
- Asistence e ngjashme eshte dhene nga Misioni per Asistence Policore e Komisionit European ne Shqiperi (PAMECA) qe nga Dhjetori 2002, perfshi asistence me zhvillim strategjish, trajnime per teknikat hetuese dhe sigurimi i pajisjeve.
- Asistence dypaleshe eshte dhene gjithashtu nga donatore sic jane Qeveria e Danimarkes dhe Norvegjise qe kane financuar projekte te vogla te policimit ne komunitet qe rreth vitit 2001.

Sipas OSBE, nje ‘Partneritet Nderkombetar’ vepron si nje forum per koordinimin e asistences policore, reformave ne polici dhe programeve te luftes kunder trafikimit dhe krimin te organizuar. Brenda Konsortiumit ka grupe te ndryshme pune qe merren me ceshtje te politikave te ndryshme.⁸²

Sic pershkruhet edhe me poshte ne paragrafin 5.1.2, struktura e brendshme e Policise Kombetare Shqiptare ka ndryshuar me kohen ne pergjigje te sfidave te hasura si krimi i organizuar dhe trafikimi dhe me qellimin per t’i luftuar keto sfida jane krijuar njesi e departamente te dedikuara, sic jane Sektori per Luften Kunder Trafikun te Paligjshem. Se fundmi, Ministria e Rendit Publik eshte kthyer ne Ministrine e Brendshme, duke marre nje rol te qeverisjes lokale, korrigjimeve dhe grumbullimeve te informacionit⁸³ pervec detyrave te saj te meparshme te policimit. Edhe pse ky ristrukturim do te krijojte sfida te shumta, duhet ne nje fare menyre te zgjidhe problemet e bashkepunimit si ato qe provuan Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Rendit Publik gjate grumbullimit te armeve.

1.9 Privatizimi i sigurise

Kompanite e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike operojne ne Shqiperi qe nga viti 1993⁸⁴ pasi rritja dhe liberalizimi ekonomik kane krijuar kerkesa per sherbime sigurie. Vecanerisht qe nga viti 1993 e ne vazhdim keto kompani kane ofruar shume sherbime,

⁸⁰ <http://www.sssr.undp.org.al/?background>.

⁸¹ <http://www.osce.org/albania/13144.html>.

⁸² <http://www.osce.org/albania/13144.html>.

⁸³ Instituti qeveritar i kerkimeve, INSTAT eshte tashme gjithashtu nen varesine e Ministrise se re te Brendshme

⁸⁴ Perpara 2001 puna e KRSF ishte e rregulluar me Ligjin Nr. 7696, date 7 Prill 1993, ‘Mbi Sherbimin e Rojeve Civile’ dhe Ligji Nr 7985, date 13 Shtator 1995, ‘Per disa Shtesa dhe Ndryshime ne Ligjin Nr. 7696,’ date 7 April 1993, ‘Mbi Sherbimin e Rojeve Civile’. Ky legjislacion u shfuqizua pas miratimit te legjislacionit te ri ne 2001. Shiko Faqen et al., f. 9–16.

perfshi mbrojtje nga afer, pergjigje te shpejte dhe kalim te sigurt te parave dhe te gjerave me vlere. Klientet tani perfshijne normalisht bankat private, bizneset nderkombetare, institucione nderkombetare, dhe sheshe ndertimi si dhe nje numer i vogel individesh ne nevojte per mbrojtje te afert.⁸⁵ Meqenese ligji parashikon numrin e personelit qe cdo kompani sigurimi mund te munesoje (ata nuk duhet te kalojne mbi pese per qind te numrit te policeve ne te njejtin qark) shume nga kompanite kane ngelur te vogla.⁸⁶ Shume nga firmat operojne ne Tirane ku jane te vendosura organizatat me klientelen me te madhe. Ne pergjithesi, vendasit duket se besojne se KRSF kane dhene nje kontribut pozitiv per parandalimin e krimit.⁸⁷ Per shembull instalimi i kamerave te fshehta dhe prezenca e rojeve te ruajtjes se sigurise fizike ne banka duket te kete nje efekt dekurajues mbi krimin, dhe shume institucione publike, si muzeume, tani kontraktujne KRSF duke besuar se kjo do tu jape atyre mbrojtje te plote.

Brenda Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit per licensimin e firmave eshte pergjegjes nje komision prej 3 vetesh. Gjithsesi, nje monitorim i perditshem i KRSF fillon ne Drejtorine e Policimit ne Komunitet dhe Grumbullimin e Armeve ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise dhe me specialistet e saj ne drejtori te ndryshme te policise se shtetit ne qarqe. Ky komision dhe specialistet e saj ne Drejtorite e Qarkut te Policise jane pergjegjes per kryerjen e inspektimeve periodike te kompanive, te dokumentacioneve dhe punonjesve te tyre gjate oreve te sherbimit dhe stervitjes. Licensat e kompanive rishikohen cdo vit nga policia dhe nese ka patur parregullsi, licensa nuk rinovohet perseri.

Edhe pse ligji aktualisht ndalon nepunesit e policise te punojne edhe si roje sigurie,⁸⁸ Drejtoret Teknike kerkohen me ligj te kene rreth 5 deri ne 10 vjet experience policore ose ushtarake, qe do te thote se shume ish-oficere policie perfundojne te punojne si roje. Megjithate kjo vlen vetem per nje pakice rojesh qe punojne ne kete sektor dhe shumica e tyre nuk e kane kete eksperience. Rojet te rinj kerkohet te marrin trajnim perpara se ata te marrin nje license (ligji kerkon qe stafi te trajnohet nga Drejtuesi Teknik i kompanise per 15 dite kohe pas se ciles ata duhe te kalojne nje test administrativ nga Policia e Shtetit). Trajnimi mbulon rregullat qe qeverisin sektorin dhe nder te tjera dhe perdorimin e armeve. Sidoqofte ndersa trajnimi administrohet nga vete KRSF-te, cilesia e tij ndryshon shume dhe edhe pse policia ka te drejte te inspektojte trajnimin, ata nuk e administrojne apo certifikojne ate. Edhe shkalla ne te cilen policia monitoron trajnimin ndryshon shume nga qarku ne qark.⁸⁹ Edhe pse nje shoqate tregetie eshte krijuar se fundmi nuk mendohet te kete zhvilluar nje kod sjellje per anetaret e saj apo te kete rritur standartet.

Nje manual i pergatitur nga MB per KRSF-te jep instruksione per perdorimin e forces se rojeve, ku kerkohet:

Roja te perdore minimumin e forces se kerkuar. Kjo nenkupton se forca ushtrohet menjehere ne rrethana ku duket te jete e nevojshme dhe ushtrimi i dhunes ndalon menjehere me zhdukjen e atyre rrethanave. Shkalla dhe intesiteti i forces varen nga rezistenca dhe mjetet e kundershtrartit.⁹⁰

Manuali thekson se armet e zjarrit mund te perdoren vetem ne 'raste ekstreme' per mbrojtjen e jetes se rojes, te jeteve te tjera, ose per te parandaluar shkaterimin e pasurive dhe pronave per te cilat ata jane te ngarkuar. Gjithsesi, mendohet se legjislacioni qe qeveris KRSF do te perfitonte nga shpjegime dhe perpunime te

⁸⁵ Ne pergjithesi, individet nuk ndejne nevojten te kontraktujne nje KRSF per mbrojtje personale. Si rregull, nese nje person merr nje kercesim per jeten e tij ose pronen e tij ai kerkon mbrojtje te perkohshme nga policia e shtetit. Policia e shtetit zakonisht siguron mbrojtje edhe politikaneve.

⁸⁶ Ligji kerkon qe drejtuesit teknike dhe punonjesit e KRSF te jene qytetare shqiptare dhe te kene leje te perhershme qendrimi ne Shqipëri. Ligji Nr 8770, date 19 Prill 2001, 'Mbi Sherbimet e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike,' Neni 2, Paragrafi 2. (Gazeta Zyrtare Nr 23, Maj 2001).

⁸⁷ Shiko Faqen, Op Cit.. Ndikimi KRSF ne parandalimin e krimit u permend dhe nga zyrtare te Policise se Shtetit te intervistuar si dhe ne fjalimin e Drejtorit te Perjgithshem te Policise se Shtetit ne takimin me administratore te KRSF ne 6 Dhjetor 2004.

⁸⁸ Op cit Page et al.

⁸⁹ Ibid.

⁹⁰ Tusha, P dhe Softa, F, Shoqerite e ruajtjes, (Europa, 1997), p. 53.

metejshme mbi perdorimin dhe dorezimin e armeve te zjarrit, kur mendohet qe armet e zjarrit qe jane aktualisht ne perdorim nuk jane te pershtatshme per sigurimin e punes. Administratore te ndyshem dhe drejtues teknik te KRSF keshilluan zevendesimin e pushkeve luftarake Kallashnikov me arme qe jane me pak te renda per tu mbajtur dhe te nje kalibri te ulet.

Pavaresisht standarteve le ulta te profesionalizmit, nje ekzaminim i raporteve te medias per keto vitet e fundit, tregon vetem pak raste te punonjesve te KRSF-ve te kene perdorur force, te kene kryer krime apo te kene abuzuar me te drejtat e njeriut. Per shembull, ne 23 Janar 2005 nje punonjes i KRSF qe jeton ne Shkoze, 6 km larg Tiranes, u perfshi ne nje grindje me arme per te drejtat mbi pronen dhe qelloi mbi dy njerez, duke vrare njerin prej tyre dhe plagosur tjetrin.⁹¹ Fakti qe ky incident ndodhi jashte orarit te detyres se punonjesit ve ne pyetje edhe mcurine per te lejuar punonjes te KRSF t'i marrin armet e kompanise me vete ne shtepi, dhe per kontrollet per eksperiencen qe u behen punonjesve te rinj. OJQ qe punojne per te drejtat e njeriut ne Shqiperi nuk kane raportuar, per ndonje perdorim te tepert force ose armesh zjarri, ne rregjistrat e tyre.⁹² Ne 2004 Drejtori i Pergjithshem i Policise citoi dy raste kur punonjesit e KRSF kishin perdorur armet e tyre ne menyre te paligjshme dhe 57 raste veniesh gjobash ndaj administratoreve, drejtoreve teknike dhe punonjesve.⁹³

Fakti qe rojet e sigurise fizike lejohen ligjerisht te mbajne arme ushtarake, te perdorin armet e tyre dhe t'i mbajne ato ne shtepi, sjell me vete rrezikun e keqperdorimit te armeve ne mjedisin familjar. Duke qene se krimi i organizuar eshte nje problem domethenes ne Shqiperi, dikush mund te mendoje se ka lidhje ndermjet grupeve kriminale dhe KRSF dhe madje per ato kompani te veprojne si mburoja ndaj krimit. Megjithate nuk duket te kete ndonje evidence te forte per te mbeshtetur nje lidhje te tille. Lidhjet politike mund te jene me shume problem dhe shume deklarata jane bere se ne vitet e para pas aprovimit te ligjit per KRSF, licensat per te drejtuar nje kompani te tille i jepeshin vetem mbeshtetesve te Partise Demokratike, e cila ishte ne pushtet ne ate kohe.⁹⁴ Ndoshta me shume problematike sesa sektori formal jane individet e shumte qe ofrojne te japin sherbime sigurimi kundrejt nje pagese. Ata zakonisht punesohen nga kompani me te vogla qe nuk ia lejojne vetes ose nuk duan te paguajne per nje KRSF. Duket qarte se keta individe punojne jashte kornizes se rregullores dhe ndoshta me arme pa leje, dhe edhe pse kjo mbetet per tu provuar.⁹⁵ Eshte gjithashtu nje praktike e zakonshme per kompanite dhe organizatat e mesme te punesojne si roje sigurie individe ne borderone e kompanise sesa te lidhin nje kontrate me nje KRSF. Kjo praktike nuk mbeshtetet nga ligjet perkatese dhe si rrjedhim eshte e paligjshme.

1.10 Ndikimi politik dhe social i reformes ushtarake

Ne Dhjetor 1992 Shqiperia u be vendi i pare i EQL qe kerkoi anetaresim ne NATO dhe eshte angazhuar me pas ne nje detyre teper kerkuese duke u perpjekur te permbushe standartet e vena nga NATO.⁹⁶ Edhe pse ushtaraket kane shprehur pakenaqesite e tyre me kontrollet civile,⁹⁷ mund te argumentohet se ndoshta kjo eshte nje shprehje pakenaqesie ndaj perpjekjeve per ta perdorur ushrine per qellime dhe beteja politike. Per shembull, nje sere njesish ushtarake u raportuan te mos ishin te gatshem te qellonin civilet gjate pasigurise se 1997. Gjithsesi nuk eshte vetem PD qe pushoi personelin ushtarak per shkak te lidhjeve te tyre politike. Kur PS mori pushtetin ne 1997, nje nga veprimet e saj te para ishte pushimi i 1,500 oficerëve qe kishin lidhje

⁹¹ Topollaj D & Karaj V, 'Si me qelluan per nje cope toke,' Panorama, 24 Janar 2005.

⁹² Interviste me Prof. Dr.Valentina Hysi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 27 Janar 2005; Edmond Prifti, Grupi Shqiptar i te Drejtave te Njeriut, 21 Janar 2005.

⁹³ Fjalimi nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit, 6 Nentor, 2004.

⁹⁴ Op cit, Page et al.

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ Qe nga mesi i viteve 1990, MB Shqiptare ka paraqitur Programe Individuale Partneriteti nen Plan Veprimi Anetaresues te OTAV per PpP. Greenwood D, Transparence dhe Besueshmeri ne Mbrojtjen e Europes Juglindore (George C. Marshall Association, Bullgari, 2003).

⁹⁷ Op cit Bahaja.

politike me PD.⁹⁸ Eshte ndoshta si rezultat i ketyre incidenteve, pervec normave nderkombetare, qe Neni 168 i Kushtetutes Shqiptare te 1998 i ben thirrje FASH te jete neutrale ne ceshtjet politike, ne vend qe te administrohet nga kontrolli civil.

Pavaresisht nga veshtiresite e manifestuara te vena re ne reduktimin e personelit ushtarak ne nje fare menyre, eshte e mundur ta shohim FASH si ‘nje nga, per te mos thene, sektori me i suksesshem ne procesin e reformes’.⁹⁹ Ne periudhen 1992–1997, u raportua nje renie prej 66 per qind e numrit te personelit ushtarak, dhe gjithashtu nje renie morale kur oficeret me experience dhe miqte e vjeter u larguan, kushtet e jeteses u perkeqesuan dhe u dobesua ‘pronesia’ e e politikeve mbi ushtare.¹⁰⁰ Personeli ushtarak ne sherbim dhe ne pension kishte gezuar kushte te privileguara jetese nen rregjimin e Hoxhes, dhe tani me ardhjen e reformes, ish-personeli dhe ai aktual ndjejne te kene humbur konsiderueshem.

Nje mungese programesh ritrajnimi per ushtarakun ka bere qe disa ish ushtarake te ndjejne justifikojne pjesemarrjen e ish kolegeve te tyre ne aktivite kriminale si trafikimi i armeve.¹⁰¹ Sic u deklarua me siper, disa nga ish personeli i sigurise dhe ai ushtarak qe organizuan grabitjen e depove te armeve ne vitin 1997, ishin te interesuar ne perfitimet qe do kishin nga shitja e ketyre armeve me teper sesa nga nxitja e nje kryengritjeje politike. Elez Biberaj ka argumentuar se ish ushtarake shqiptare, police dhe agjente sekrete u angazhuan ne aktivite kriminale te krimit te organizuar transnacional¹⁰², ndersa te tjere qe kane verejtur se aktivitetet e tyre te kontrabandes mund te mos jene vezhguar nga personeli shtetror per arsye ideologjike (psh, nese armet coheshin kontrabande ne KLA), per perfitime ose arsye te tjera personale (psh, eshte perfshire nje anetar i familjes).¹⁰³ Fakti qe aftesite dhe kontaktet e fituara gjate karrieres ushtarake mund te transferohen ne menyre te suksesshme ne boten e krimit te organizuar dhe aktivitetet e trafikimit, nuk eshte nje problem vetem per Shqiperine. Eshte zbuluar edhe ne pjese te tjera te ish bllokut komunist dhe me gjere.¹⁰⁴ Nevojiten te merren masa te metejshme per t’u siguruar qe ky shteg tranzicioni te mbyllet per personelin ish ushtarak dhe qe krimi i organizuar dhe aktivitetet e trafikimit te mos perfshijne personelin ne sherbim.

1.11 Armet, grushtet e shtetit dhe zgjedhjet

Mbikqyrja parlamentare ka qene viktime e panorames se ashpër bipartizane politike ne Shqiperi, me PD qe bojkotonte Parlamentin Shqiptar per pjesen me te madhe te kohes kur PS ishte ne pushtet.¹⁰⁵ Megjithese ka patur perpjekje te perseritura per zgjedhje dhe anashkalime te parlamentit, sikurse nje analist shkruan ne 1999, ka patur gjithashtu disa “tregues qe elemente te Partise Demokratike te cilet ishin te gatshem te perdornin metoda jashte-politike ne perpjekje per te rifituar pushtetin”.¹⁰⁶ Pas fitores se zgjedhjeve 1997, Partia Socialiste pretendoi ne disa raste qe cilat Berisha dhe PD planifikuan te organizonin nje grusht shteti. Per shembull, arme zjarri ishin shperndare nga mbeshtetesit e PD ne nje numer te madh rastesh ne 1998, me episode ne Shkoder gjate muajit Shkurt dhe ne Tirane gjate muajit Shtator te cilat u etiketuan si “perpjekje per grusht shteti” nga Qeveria e PS – nje pretendim ky i mohuar me force nga ana e PD-se.¹⁰⁷

⁹⁸ Op cit Bumçi, p. 6.

⁹⁹ Kajsio B, ‘Transparence dhe Besueshmeri ne qeverisje’, ne Reformen e Mbrojtjes dhe Sektorit te Sigurise ne Europen Juglindore: Veshtrim i brendshem dhe PERSpektivat – Shqiperia: Nje studim vete-vleresimi, (DCAF, 2003), f. 120.

¹⁰⁰ Op cit Bahaja.

¹⁰¹ Interviste, perfaqesues i OJF, 25 Prill 2005.

¹⁰² Op cit Biberaj, f. 322.

¹⁰³ Op cit Grupi i Krizave Nderkombetare, f. 13.

¹⁰⁴ Per shembull, shiko: Armet tregtohen tranzit ne rajonin e detit Balltik (Saferworld, 2003); op cit Bebler; op cit Davis, Hirst dhe Mariani; Galleotti M, ‘Ushtria Kriminale e Rusise’, *Revista Inteligjente Jane*, 11(6), Qershor 1999, pp. 8–10; Galleotti M ‘Sfida e ‘sigurimit te bute’: Krimi, korrupsioni dhe kaosi’, ne Sfidat e Reja te Sigurise ne Europen Post-Komuniste: Sigurimi i Europes Lindore, eds Cottey A and Averre D, (Shtypi i Universitetit te Manchesterit, 2002), pp. 151–71.

¹⁰⁵ Midis 1997 dhe 2003, PD bojkotoi parlamentin ne disa raste dhe per periudha te gjata.

¹⁰⁶ Smith M A, Albania 1997–1998, (Qendra per Studimet e Konflikteve S42, 1999), fq. 3.

¹⁰⁷ Ibid; op cit Bowcott; op cit Coleman; op cit Pettifer, 1998.

I fundit i ketyre episodeve u shoqerua dhe me vrasjen e nje anetari te kryesise se PD-se, Hajdari ne Shtator te 1998. PD asokohe pretendoi se pas kesaj vrasjeje ishin anetare te PS-se. Ndaj kur ne vitin 2002 hetimet per angazhim ne aktivite ilegale te Kryetarit te Sherbimit Kombetar Informativ, Fatos Klosi nuk provuan gje per perfshirjen e tij ne vrasjen e Hajdarit, PD bojkotoi raportin perfundimtar mbi Klosin si dhe nisi nje bojkot tjeter ndaj Parlamentit ne Janar 2003.¹⁰⁸ Pavarsisht faktit se Biberaj thekson qe transferimi i pushtetit nga socialistet tek PD ne 1992 ishte “konsiderueshem paqesor dhe gradual”, trembedhete vitet e shkuara kane shenuar nje nivel te larte polarizimi dhe mos-bashkepunimi midis dy partive kryesore gje qe ka vonuar zhvillimin e praktikave demokratike brenda Shqiperise,¹⁰⁹ shoqeruar me lufte per pushtet mes PD-se dhe PS-se qe ka patur si pasoje thellimin e paralizes politike.¹¹⁰

Sipas vezhguesve nderkombetare, pavarsisht disa situatave me dhune dhe kercenime, procedurat zgjedhore dhe metodat e kryerjes se fushatave jane permiresuar ne cdo proces gjedhor lokal dhe kombetar qe prej vitit 1997. Zgjedhjet parlamentare te vitit 2005, u pane nga vezhguesit nderkombetare si nje test kufi per proceset demokratike ne Shqiperi, meqenese u parashikuan se do te ishin shume afer me rezultatet – nje sondazh paraprak i ndermarre ne 26 Qershor 2005 i dha respektivisht PD-se dhe PS-se 35 dhe 34 per qind.¹¹¹ Fushata zgjedhore u turbullua nga raporte te ndryshme mbi kercenime dhe sulme ndaj kandidateve apo mbeshtetesve te partive te ndyshme,¹¹² dhe ne ditën e zgjedhjeve nje vezhgues i Partise Republikane, qe mbante dhe vete nje arme, u qellua per vdekje ne qendren e tij te votimit ne Tirane.¹¹³ Disa vezhgues nderkombetare theksuan elementet pozitive te kesaj fushate elektorale,¹¹⁴ dhe vleresimi i pergjithshem nderkombetar ishte qe keto zgjedhje ishin ‘pjeserisht’ ose ‘ne pergjithesi korrekte’.¹¹⁵

1.12 Transparenca

Nje nga problemet kryesore me perqasjen fituesi-merr-gjithshka ne politike, i pershtatur ne Shqiperi, eshte qe ka deshtuar rrenjosja e mbikqyrjes parlamentare. Kritika apo kerkesa per amendemante te rendesishme ne legjislacionin vendas duket se ka mbetur nje atribut vetem i opozites apo fraksioneve te saj. Meritat e vecanta, sfidat e legjislacionit, apo strategjive kombetare nuk debatohen apo vleresohen nga parlamentaret e Shqiperise. Ne vijim, fakti qe seksione te medha te medias kufizojne diskutimin e ceshtjeve aktuale vetem tek ato ne lidhje me vrasjet, polemikat politike dhe lajmet sensacionale, nuk ndihmojne ne informimin e gjere te publikut dhe pajisjen e tij me informacionin e duhur per tu angazhuar ne jeten politike te vendit.

¹⁰⁸ Op cit International Crisis Group, 2003, p. 4.

¹⁰⁹ Ibid; op cit Greenwood.

¹¹⁰ Per shembull shiko: Aliaj I, ‘Shqiperia: Lufte e brendshme qe percakton qeverine’, IWPRBCR 450, 6 August 2003, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; Harizaj E, ‘Berisha germon marrevshjet e bashkepunimit’, IWPRBCR 397, 13 January 2003, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; Ilirjani A, ‘Shqiperia dhe Bashkimi Evropianb’, Mediterranean Politics, 9(2), 2004, pp. 258–264; Ilo M, ‘Bsalothazhi Shqiptar shkaktonte stuhine politike’, IWPRBCR 126, 21 March 2000, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; op cit International Crisis Group, 2003; Nazi F, ‘Shpresa e Perendimit – qe brezi I ri do te sillte normalitet ne skenen politike shqiptare – eshte venitur’, IWPRBCR 83, 12 October 1999, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; Semini L, ‘Shqiperia: Bllokimi politik I thyer’, IWPRBCR 345, 26 June 2002, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; Semini L, ‘Shqiperia: Lufta e brendshme politike kercenon ekonomine’, IWPRBCR 315, 6 February 2002, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005; Shameti S, ‘Shqiperia: Lufta per pushtet del ne krye’, IWPRBCR 467, 6 November 2003, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 May 2005.

¹¹¹ Sondazh publik Zgjedhje 2005: (Permbledhje te detajeve kyce (Mjaft dhe Gallup International, Tirana, 26 Qershor 2005), fq. 15.

¹¹² Musta S, ‘Fushata e zgjedhjeve ne Shqiperi shnderrohet ne rrezik’, IWPRBCR 561, 23 June 2005, <<http://www.iwpr.net/>>, 24 August 2005.

¹¹³ ‘Nje zyrtar I Partise Republikane u vra per arsye politike’, Ceshtje te Krimet dhe Korrupsionit ne Shqiperi, 2–8 Korrik 2005. Burimi: Shekulli, 5 Korrik 2005. ‘Vezhguesi I Partise Republikane vdes ne ditën e zgjedhjeve ne Shqiperi’, Shebimi monitorues i BBC, United Kingdom, 5 Korrik 2005. Burimi: Shekulli, Tirana, ne shqip, 4 Korrik 2005, p. 7. Prezumimet e ndryshme qe gazetaret ngriten nuk preku asnje cedshjen se pse nje vezhgues ditën e zgjedhjeve mbante me vete nje arme zjarri.

¹¹⁴ Sipas nje raporti, PAMECA pohon se policia e shtetit ishte ‘efektshe e menaxhuar dhe organizuar’ gjate zgjedhjeve dhe puna e tyre u krye ‘ne menyre te paanshme dhe ne perputhje me kerkesat e bera ndaj saj’, Sherbimi Monitorues i BBC, United Kingdom, 5 Korrik 2005. Burimi: Agjensia e lajmeve ATA Tirana, ne anglisht, 1400 gmt, 5 Korrik 2005.

¹¹⁵ Rrjeti Evropian i Organizatave qe monitorojne zgjedhjet, BE dhe OSBE bene keto vleresime. Per shembull shiko: ‘Zgjedhjet shqiptare permbushen pjeserisht standartet demokratike – perditetim OSBE’, AFX Europe (Focus), 4 July 2005; ‘Shefi I Politikave te jashtme te BE kerkon proven e zgjedhjeve shqiptare’, AP Worldstream, 4 July 2005; ‘Trupi ndekombetar i monitorimit thote per zgjedhjet shqiptare “ne pergjithesi te drejta”’, Sherbimi monitorues i BBC, United Kingdom, 4 Korrik 2005, Burimi: TV Shqiptare, Tirana ne shqip, 0600 gmt, 4 Korrik 2005; ‘Monitoruesit nderkombetare, kritike ndaj zgjedhjeve ne Shqiperi’, AP Worldstream, 4 Korrik 2005.

Pa dyshim që një nga problemet për të arritur një angazhim më të madh të opinionit publik, dhe një debat të informuar mbi çështjet e qeverisjes në Shqipëri, është që sistemi bazë i të dhënave të informacionit kombëtar mungon. Për shembull, kur të dhënat ju dhane ekipit të këtij studimi, gati çdo i intervistuar i huaj por dhe shumë të intervistuar vendas terhoqën vemendjen e studiuesve në lidhje me mungesën e besimit në shifrat shqiptare. Duhet shënuar, megjithatë që mungesa e besimit ndaj këtyre të dhënave nuk i atribuohet detyrësisht veprimeve me qëllim të dyshimta, por me shumë vështirësi të komunikimit në kohe reale dhe mbajtjes/rregjistrimit korrekt të të dhënave në Shqipëri. Për shembull kur SHBA, zbuloi se rezultatet mbi programin e shkatërrimit MANPAD, të financuar nga SHBA në Shqipëri, ishin dy MANPADs me pak se sa kishin deklaruar shqiptarët se kishin, ata i kërkuan shpjegimet përkatëse Qeverisë Shqiptare. Rezultati ishte që dy njesitë e MANPAD 'të humbura' ishin raportuar si të shkatërruara përpara se programi i financuar nga SHBA të fillonte. Ky informacion, thjesht nuk kishte mbërritur tek ata që pergatiten projektin e MANPAD për Shqipërinë në SHBA. Ky është vetëm një shembull i problemeve që hasen si rezultat i infrastruktures së dobët në komunikimit në Shqipëri.